



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 19/1 Prot.

Tiranë, më 06.01.2026

V E N D I M

Nr. 1, Datë 06.01.2026

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 328, datë 22.12.2025, e paraqitur nga znj. L.Gj kundër Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë, Epror, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “gjendjes shëndetësore”.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna, ankuesja në mes të tjerash informon se: “Unë L.Gj, lindur me datë 28.01.1965 në Laç, paraqes shqetësimin tim lidhur me disa të drejta që KMCAP Epror Tiranë, ka kryer disa veprime që prekin të drejtat që më përkasin në gjendjen time shëndetësore, ku theksoj që duke filluar nga 31.01.2021, më hoqën të drejtën e trajtimit të statusit paraplegjik-tetraplegjik të grupit të parë me përkujdesje sociale. Kujdestaria mbulohej nga bashkëshorti im, ku dhe sot nuk trajtohem me këtë të drejtë. Jam ankuar shumë herë dhe nuk më janë përgjigjur duke u futur dhe ato vetë në konflikt me njëri-tjetrin sipas vendimeve që kanë marrë me përmbytje të ndryshme.

Së pari - Dëshiroj të paraqes kronikën e sëmundjes time nga fillimi e deri më sot. Unë jam sëmurë në vitin 2007 dhe kam vazhduar shërbimet shëndetësore në spitalin Universitar Nënë Tereza Tiranë në pavijonin e Hematologjisë, deri në shtator 2009. Analizat dhe kontrollet e kryera konstatuan se isha prekur nga një sëmundje e thellë me diagnozë “anemi aplastike”

(Palca e kockës) dhe pranë shërbimit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë ishte i pamundur kurimi, duke më deleguar që vetëm në shtetin Italian mund të gjendej shërimi. Në fund të shtatorit 2009 jam gjendur në spitalin Papa Gjovani Bergamo Itali ku me marrëveshje mes meje dhe mjekut, filluam terapinë intensive prej 16 vitesh deri në kryerjen së fundmi të transplantit të palcës dhe përfundimisht është vendosur nga komisioni mjeko ligjor në Itali se gjendja ime shëndetësore do të jetë gjithmonë nën kujdesin shëndetësor, si dhe nuk do të jetë e nevojshme të paraqitem në asnjë lloj komisioni, mbasi gjendja ime është e përhershme dhe nuk do të kem as shikim as rishikim”.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi konstatimin e diskriminimit dhe rikthimin e të drejtave që i janë cenuar me pagesën sociale si dhe ndaj shërbimit të kujdestarisë si invalid, me diagnozë të statusit paraplegjik-tetraplegjik.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:

Parimi i barazisë para ligjit dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta në nenin 18, si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët. Gjykata Kushtetuese në disa vendime të saj ka interpretuar nenin 18 të Kushtetutës, si dhe ka theksuar se parimi i barazisë synon që të gjithë të jenë të barabartë në ligj dhe përpara ligjit, jo vetëm në të drejtat themelore të parashikuara në Kushtetutë por edhe në të drejtat e parashikuara nga ligjet e tjera në fuqi. Gjykata është shprehur se: “*Barazia në ligj dhe para ligjit nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëllajta për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme. Barazia përpara ligjit dhe në ligj presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta*”, si dhe “*Vetëm në raste përjashtimore dhe për shkaqe të arsyeshme dhe objektive mund të përliqet trajtimi i ndryshëm i kategorive të caktuara që përfitojnë nga kjo e drejtë*” (shih vendimet nr. 39, datë 16.10.2007, nr. 4, datë 12.02.2010, nr. 34, datë 20.12.2015, të Gjykatës Kushtetuese).

Neni 14 i Konventës Evropiane për Drejtat e Njeriut (KEDNJ), ndalon diskriminimin në gëzimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në të, ndërkohë që Protokolli 12-të i KEDNJ-së, i cili është ratifikuar nga Shqipëria, ndalon diskriminimin në lidhje me “*gëzimin e çdo të drejte të parashtruar nga ligji*” dhe kështu ofron mbrojtje më të madhe se sa neni 14, i cili lidhet vetëm me të drejtat e garantuara nga KEDNJ-ja. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), në mënyrë të vazhdueshme ka interpretuar se “*diskriminimi*” do të thotë që të trajtosh ndryshe pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, persona të cilët ndodhen në situata të ngjashme dhe diferenca në trajtim, nuk bazohet në ndonjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, domethënë, se trajtimi i diferencuar nuk ndjek një qëllim legjitim dhe nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme të proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të realizohet. Sipas GJEDNJ, e drejta për të mos u diskriminuar e garantuar nga KEDNJ, gjithashtu cenohet kur pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm shtetet dështojnë që të trajtojnë ndryshe personat situata e të cilëve objektivisht e ndryshme.

Ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh, por në mënyrë të shprehur nën 1, i ligjit parashikon mbrojtjen nga diskriminimi për një listë joshtruese shkaqesh. Në këtë nen parashikohet shprehimisht se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”

Sipas nenit 3, pika 1, të LMD, të ndryshuar, përcaktohet se: “1. “Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.

Në bazë të nenit 7, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprimi të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Nga shqyrtimi paraprak i parashtrimeve dhe dokumentacionit të depozituar nga ankuesja pranë KMD-së, konstatohet se:

Referuar Fletë Drejtimi për KMCAP nr. 795, datë 05.05.2023 të lëshuar nga Spitali Laç, znj. L.Gj ka diagnozën: “1. Tetraparezë e rëndë me predominim inferior në terren polineuropatie të rëndë metabolike me çrregullime sfinkteriane. 2..... 3..... 4.....”.

Referuar shkresës nr. 975, datë 23.02.2024, të Sektorit të Ndihmës Ekonomike dhe Paaftësisë të Bashkisë Kurbin, vërtetohet se:

“Znj. L.Gj është trajtuar me pagesë për Statusin Para-Tetraplegjik nga data 01.10.2016 me vendimet si më poshtë:

1. Vendimi nr. 568, datë 05.08.2016 me afat 01.10.2016 deri me 30.09.2017.
2. Vendimi nr. 562, datë 05.09.2017 me afat 01.10.2017 deri me 30.09.2020.
3. Vendimi nr. 3921, datë 19.01.2021 divergjencë në Kemp Epror.
4. Vendimi nr. 977, datë 23.12.2021 nga Kemp Epror, Pa Grup për mosparaqitje në Kemp Epror.

5. *Vendimi nr. 1842, datë 29.08.2023 nga Niveli i I (parë) ardhur Pa Grup për arsye se nuk është realizuar videocall.*

Vërtetohet se gjatë kësaj periudhe është trajtuar me pagesë si kujdestar i saj ligjor z. P.Gj, me nr. dosje 128, nga data 01.10.2016 deri me datë 31.01.2021”.

Lidhur me pretendimet e ankueses, për kundërshtimin dhe mosdakordësinë e saj me vendimin e KMCAP Epror, Komisioneri vlerëson se, rimarrja në shqyrtim e vendimeve të këtyre organeve, të specializuara mjeko-ligjore siç janë: Komisioni Shumëdisiplinor i Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar apo KMCAP Epror, nuk bën pjesë në kompetencat e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Në nenin 8/c) të ligjit nr. 57, datë 18.07.2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, përcaktohet se: “Përfitues të pagesës për aftësinë e kufizuar janë: a) personat paraplegjikë dhe tetraplegjikë, të cilët deklarohen me vendim të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë se janë bërë të tillë, pavarësisht nga shkaku dhe mosha; b) personat me aftësi të kufizuar, të cilët deklarohen të paaftë për punë me vendim të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë, si dhe personat e paaftë për punë, sipas Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë, të cilët nuk plotësojnë kushtet ligjore për përfitim të pensionit të invaliditetit të punës sipas ligjit të sigurimeve shoqërore në Republikën e Shqipërisë; c) personat me aftësi të kufizuar, të deklaruar të tillë me vendim të Komisionit Shumëdisiplinor të Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar;...”, ndërsa në nenin 10 përcaktohet se: “Personat përfitues, që përcaktohen në germat a, b dhe c, të nenit 8, të këtij ligji, të cilët, me vendim të komisioneve të vlerësimit, të parashikuar nga ky ligj, përcaktohen se kanë nevojë për përkujdesje, përfitojnë edhe një ndihmës personal me pagesë”.

Neni 29 i këtij Ligji, shprehet në mënyrë të detajuar për procedurën e ankimimit, në rastet kur aplikuesit/përfituesit nuk janë dakord me vendimmarrjet e komisioneve të vlerësimit të aftësisë së kufizuar, duke përcaktuar se:

“1. Aplikuesi për përfitimin e ndihmës ekonomike, kur gjykon se vendimi zyrtar i organit përkatës është i padrejtë dhe personi me aftësi të kufizuar, kur gjykon se i është shkelur një e drejtë e garantuar nga ky ligj, mund të paraqesin ankesë me shkrim pranë bashkisë/njësisë administrative brenda 20 ditëve kalendarike nga marrja e njoftimit. Struktura vendore shqyrtton ankesën dhe njofton me shkrim ankuesin brenda 7 ditëve kalendarike nga marrja e ankesës.

2. Aplikuesi për përfitimin e ndihmës ekonomike dhe personi me aftësi të kufizuar kanë të drejtë të paraqesin ankesë me shkrim pranë strukturës rajonale të Shërbimit Social Shtetëror brenda 20 ditëve kalendarike nga marrja e përgjigjes nga struktura vendore, pas ezaurimit të ankimit, të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.

3. Struktura rajonale e Shërbimit Social Shtetëror, pas shqyrtimit dhe verifikimit të ankesave, njofton me shkrim të interesuarin dhe njësinë e vetëqeverisjes vendore brenda 14 ditëve kalendarike nga marrja e ankesës.

4. Aplikuesi për përfitimin e ndihmës ekonomike dhe personi me aftësi të kufizuar, që pretendojnë se u është shkelur dhe/ose mohuar një e drejtë ligjore, gëzojnë të drejtën për të ngritur padi në gjykatë, në përputhje me legjislacionin në fuqi për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

Në Kreun IV të VKM-së nr. 182, datë 26.02.2020, “Për përcaktimin e masës, të kriterëve, procedurave e dokumentacionit për vlerësimin dhe përfitimin e pagesës për personat me aftësisë së kufizuar, si dhe të ndihmës personal”, përcaktohet procedura dhe dokumentacioni për vlerësim dhe përfitim për shkak të aftësisë së kufizuar, në të cilën parashikohet që: “1. Personat, që vlerësohen me aftësi të kufizuar, pajisen nga institucioni i kujdesit shëndetësor, i specializuar me shtretër, me fletën e drejtimit për në KMCAP. Personat, që rivlerësohen për aftësinë e kufizuar, pajisen nga mjeku specialist me epikrizë, në bazë të rekomandimit të mjekut të familjes. Dokumentacioni për vlerësimin/rivlerësimin e aftësisë së kufizuar, së bashku me kopje të dokumentit të identifikimit, dërgohen brenda 5 (pesë) ditëve nga institucioni shëndetësor pranë njësisë administrative ku individi ka vendbanimin. 2. Për personat me aftësi të kufizuar, për të cilët me vendim të komisionit mjekësor është përcaktuar se kanë nevojë për përkuqdesje, plotësohet brenda 30 (tridhjetë) ditëve dokumentacioni për ndihmësin personal, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për mënyrën e ofrimit të ndihmesës personale dhe kriteret e përzgjedhjes së ndihmës personal. 3. 4. 5. 6. Administratori shoqëror, me marrjen e dokumentacionit nga institucioni shëndetësor, e dërgon atë brenda 24 (njëzet e katër) orëve, me procesverbal, pranë mjekut të drejtorisë rajonale të shërbimit social shtetëror, dhe listën emërore të personave që do të vlerësohen apo do të rivlerësohen, pranë KMCAP-së. Mjeku verifikon nëse dosjet e paraqitura janë të plotësuara me dokumentacionin përkatës dhe, më pas, i përçjell ato në KMCAP. Mjeku mban regjistrin e personave me aftësi të kufizuar, sipas pikës 1, të kreut I, të këtij vendimi. 7. Në rastet e rivlerësimit, administratori shoqëror njofton personin 2 (dy) muaj para përfundimit të afatit të vlerësimit për pajisjen me epikrizën përçjellëse. 8. Personat, të cilëve u ndryshon gjendja shëndetësore brenda afatit të përfitimit, i nënshtrohen procedurës së rivlerësimit me fletëdrejtimi të re. 9. Drejtoritë rajonale të shërbimit social shtetëror, në përfundim të vlerësimit të aftësisë së kufizuar për personat aplikues, hedhin në arkivin elektronik, brenda 10 (dhjetë) ditëve, nga data e vlerësimit/rivlerësimit, dokumentacionin që përmban dosja e përfituesit dhe e dërgojnë atë pranë njësisë administrative, të shoqëruar me njoftimin për vendimin për çdo person. 10. Administratori shoqëror, në bazë të vendimeve të komisionit, përgatit listën e përfituesve të pagesës së aftësisë së kufizuar, të shoqëruar me masën e përfitimit për çdo përfitues, përfshirë edhe përfitimet shtesë, të bazuara në dokumentacionin përkatës, sipas legjislacionit në fuqi. Kjo listë i dërgohet çdo muaj strukturës përgjegjëse për shërbimet sociale në bashki për të kryer pagesat. 11. Struktura përgjegjëse për shërbimet sociale në bashki përgatit listën e plotë dhe masat e përfitimit për përfituesit e pagesave të aftësisë së kufizuar nën juridiksionin e saj dhe mundëson ekzekutimin e pagesave brenda afateve ligjore”.

Në pikat 9/a dhe 11 të VKM-së nr. 707, datë 09.09.2020, “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr. 182, datë 26.02.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e masës, të kriterëve, procedurave e dokumentacionit për vlerësimin dhe përfitimin e pagesës për personat me aftësi të kufizuar, si dhe të ndihmës personal” parashikohet shprehimisht se: “9. KMCAP-ja

eprore ka këto detyra: a) shqyrton dhe zgjidh kërkesat e personave me aftësi të kufizuara, që ankimojnë brenda 30 (tridhjetë) ditëve vendimet e KMCAP-ve të nivelit të parë, si edhe shqyrton dhe zgjidh rastet e dërguara me divergjencë nga KMCAP-ja e nivelit të parë”; “11. Në rastet kur ndërmjet anëtarëve të komisionit ka mendime të ndryshme, vendimi merret me divergjencë dhe anëtari që nuk është dakord me të tjerët argumenton vendimin me arsyet e divergjencës. Në këto raste, vendimi nuk ka fuqi ligjore ekzekutive dhe së bashku me dosjen dërgohet zyrtarisht në KMCAP-në eprore të specializuar”.

Referuar pikës 13, të VKM-së së sipërcituar rezulton se vendimi i KMCAP-së Eprore të specializuar nuk mund të ndryshohet nga KMCAP-ja e nivelit të parë. Në ato raste kur KMCAP-ja e nivelit të parë gjykon se kërkuuesi paraqet gjendje shëndetësore të rënduar dhe bën objekt për të ndryshuar kushtet e përfitimit, ai merr vendim duke argumentuar edhe arsyen e këtij ndryshimi. Në këto raste, pavarësisht vendimit të KMCAP-së së nivelit të parë, vendimi do të hyjë në fuqi vetëm pas miratimit të KMCAP-së Eprore të specializuar. Sipas aktit nënligjor të sipërcituar, vendimi i KMCAP Epror është i formës së prerë.

Në rastin konkret, KMCAP-ja me vendimin nr. 3921, datë 19.01.2021, ka kaluar vlerësimin e aftësisë së kufizuar të ankueses me divergjencë dhe ky vlerësim ka kaluar në KMCAP Epror. Ky i fundit ka marrë vendim të formës së prerë që znj. Gj nuk është përfituese për mosparaqitje në KMCAP Epror. Për analogji të neneve të sipërcituar, në rastin konkret vendimi i KMCAP Epror është i formës së prerë dhe si i tillë mund të ankimohet vetëm gjyqësisht.

Në ankesën e bërë pranë KMD-së, znj. Gj ka kundërshtuar vendimin e KMCAP Epror dhe ka kërkuar që të përfitojë të ardhura nga invaliditeti për vete dhe për ndihmësin personal, vlerësim i cili mund bëhet vetëm nga komisionet e specializuara për vlerësimin e personave me aftësi të kufizuara.

Përgjigja e argumentuar, pra vendimi i arsyetuar që marrin këto komisione, bazohet në intervistat e zhvilluara dhe lidhet kryesisht me vlerësimin dhe caktimin e diagnozës mjekësore. Për shkak të natyrës specifike apo natyrës juridike të marrëdhënies që krijohet gjatë vlerësimit të aftësive për punë, këto vendime mund të merren vetëm nga mjekët e specializuar pranë KMCAP-ve Rajonale dhe Eprore.

KMCAP-të Rajonale dhe Eprore janë ekipe të përzgjedhur, të përbërë nga mjekë dhe punonjës social, të cilët janë të punësuar pranë Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror dhe Institutit të Sigurimeve Shoqërore, si dhe janë përgjegjës për kryerjen e vlerësimit bio-psiko-social të aplikuesve për përfitimet në para dhe/ose në natyrë për shkak të aftësisë së kufizuar, bazuar në dokumentet e përgatitura nga institucionet shëndetësore, informacionin e marrë nga intervistat e zhvilluara, verifikimin dhe shkëmbimin e informacionit me institucione të tjera sociale, arsimore, shëndetësore, të punësimit e formimit profesional.

Çdo person i interesuar, i cili pretendon se i është shkelur, mohuar apo cënuar një e drejtë e ligjshme nga një organ i administratës publike, në rastin konkret, KMCAP Epror, krahas ushtrimit të së drejtës së ankimit administrativ, mund të kërkojë mbrojtjen e të drejtave të tij edhe me anë të

një mjeti tjetër ligjor, që është padia e cila ngrihet përpara Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë.

Neni 42 i Kushtetutës vendos standarde kushtetuese si për gjykatat, ashtu dhe për organet e administratës publike. Pika 2 e po këtij neni, sanksionon se kushdo mund t'i drejtohet gjykatës për të mbrojtur një të drejtë, liri apo interes kushtetues e ligjor. Kjo dispozitë, ndër të tjera, ka për qëllim të garantojë shtetasit nga çdo veprim që u shkakton cenim të të drejtave të tyre, pa përjashtuar dhe rastin kur cenimi vjen dhe nga një akt administrativ i tillë.

Ligji nr. 7703, datë 11.05.1993 *“Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar, në nenin 39/1 *“Ankimimi në Komisionin Epror”*, në pikën të 3 të tij, ka përcaktuar se: *“Vendimi i Komisionit Epror është i formës së prerë”*.

Për sa më lart, Komisioneri sqaron se, rimarrja në shqyrtim e vendimeve të këtyre organeve (KMCAP Rajonale dhe Epror) nuk bën pjesë në kompetencat e Komisionit¹.

Për sa më sipër, referuar nenit 33/4/b, të ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, i cili citon se: *“Ankesa nuk pranohet nëse: është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji”*, ankesa nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t'i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

Në përfundim, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ju rekomandon që bazuar në ligjin nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”*, i ndryshuar në ligjin 49/2012 *“Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”* i ndryshuar, dhe në ligjin nr. 57, datë 18.07.2019 *“Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”*, të ndryshuar, t'i drejtoheni Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë për të kundërshtuar vendimin e KMCAP Epror, i cili është i formës së prerë por jo përfundimtar.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi i rekomandon gjithashtu subjektit ankues, që për problematikën e saj, t'i drejtohet për ofrimin e ndihmës ligjore falas, Komisionit Shtetëror për Ndihmën Juridike², ose Shërbimit Ligjor Falas³.

PËR KËTO ARSYE :

Bazuar në nenin 33, pika 4/b, të ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

¹ Për analogji citojmë: Vendimin nr.55, datë 24.04.2019, Vendimin nr. 61, datë 12.06.2020, Vendimin nr. 59, datë 13.04.2021, Vendimin nr. 78, datë 07.05.2021 dhe Vendimin 153, datë 20.08.2021, të KMD-së, të publikuar në: www.kmd.al.

² Me adresë: Pranë Ministrisë së Drejtësisë, Blv. “Zogu i Parë”, Tiranë.

³ Me adresë: Bulevardi: “Bajram Curri”, Pall: “Agimi”, Shk. 18, Ap. 322, Tiranë, Nr.tel: 0422 53113.

V E N D O S I:

1. Mospranimin e ankesës nr. 328, datë 22.12.2025, të paraqitur nga znj. L.Gj kundër Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë, Epror, pasi nuk plotësohen kriteret përkatëse të parashikuara nga ligji 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA